



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:164687 **C. nr. 1886/2023**
Datë: 22.05.2024
Numri i dokumentit: 05717753

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari Atdhe Berisha, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional D.K. duke vendosur në çështjen juridike të paditësit A.Sh. nga Prizreni, të cilin e përfaqëson av.A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e shujtave-ushqimit gjatë punës, vlera e kontestit 286.00 €, pas dhënies së përgjigjes në padi, më datë 22.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.Sh. nga Prizreni dhe DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit që në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqimin ditor-shujtën t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 286.00 € (143 x 2), duke e llogaritur një ditë pune me nga 2 €, me kamatë prej 8% në vit, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë (01.08.2023), e deri në pagesën definitive, të gjitha në afatin prej 7 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit.

II. DETYROHET e paditura që t'ia paguajë paditësit shpenzimet procedurale dhe atë në lartësi prej 124 € në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësi A.Sh. nga Prizreni, të cilin e përfaqëson av.A.H. nga Prishtina, në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit kompensimin e shujtave-ushqimit gjatë punës, vlera e kontestit 286.00 €, ngase është kërkesë e bazuar.

E paditura duke vepruar sipas aktvendimit të gjykatës më dt. 18.03.2024 ka dorëzuar në gjykatë përgjigjen në padi me anë të së cilës e ka kundërshtuar në parim padinë dhe kërkesë padinë me arsyetim të mungesës së mjeteve buxhetore, ngase Ministria e Financave nuk ka kod të posaçëm buxhetor për këtë kategori të shpenzimeve.

Paditësi padisë ia ka bashkangjitur provat materiale si në vijim: Kontratën e punës për mësimdhënës me Nr.prot.35/16 e datës 01.09.2016, vërtetimin e lëshuar nga Drejtori i shkollës

“Mid’hat Frashëri” në fshatin Krajk, Komuna Prizren Nr.26/23 i dt. 10.02.2023, listën e pagave dhe fotokopjen e letërnjoftimit të paditësit.

Nga provat e administruara më lart nuk është kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura-shkolla fillore “Mid’hat Frashëri” në fshatin Krajk, Komuna Prizren, por mbetet kontestues fakti se paditësit a i takon kompensimi për ushqimin ditor për shujtat, për të cilën çështje gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, për shkak se kjo kërkesë e paditësit është e rregulluar me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë 01/B nr.105 të dt. 22.01.2021, konkretisht të nenit 35.7, i cili rregullon të drejtën për shujtje-ushqim ditor për ditët e kaluara në punë, në rastet kur punëdhënësi nuk e ka organizuar ushqimin në punë sikurse në rastin konkret.

Duke u bazuar në këto dispozita materiale të cilat përcaktojnë këto të drejta dhe detyrime për palët ndërgjyqjese dhe gjendjen faktike të vërtetuar, se paditësi është aktualisht në marrëdhënie pune tek e paditura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, ashtu që e detyroi të paditurën që paditësit t’ia kompensoj ushqimin ditor në shumën prej 314.00 €, duke e llogaritur një ditë pune me nga 2 €, për shkak se nga provat materiale, konkretisht vërtetimi Nr.26/23 i dt. 10.02.2023, vërtetohet fakti se paditësi për vitin 2022, për periudhën nga data 01.01.2022 deri me datë 21.11.2022, ka punuar gjithsejtë 143 ditë.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e aprovuar shumën përkatëse të kompensimit, duke e llogaritur me kamatë ligjore prej 8 %, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, nga dita e parashtrimit të padisë (01.08.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës Nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me dëm material.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale bazohet në nenit 449, 452 dhe 453.1 të LPK-së, ku është obliguar pala e paditur që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën prej 124 €, dhe atë në emër të përpilimit të padisë 104 € dhe në emër të taksës për padi 20 €, bazuar në tarifën e OAK-së.

Nga të dhënat e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 143 dhe 398 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C. nr. 1886/2023, me datë 22.05.2024

Gjyqtari
Atdhe Berisha

UDHËZIME PËR ANKESË: kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.